



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 21, datë 18. 07. 2012

**PËR**

**“MIRATIMIN E ANTARËSIMIT DHE FINANCIMIT TË KUOTËS SË ANËTARIT TË ASOCIUAR TË BASHKISË SË TIRANËS NË EUROCIITIES, RRJETI I QYTETEVE MË TË MËDHA EUROPIANE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/V, gërma “b” e “c”, nenit 19, pika 9 dhe nenit 32, të ligjit nr. 8652, datë 31. 07. 2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), nenit 10 të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 për “Ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 25, datë 28.12.2011 për “Miratimin e buxhetit të vitit 2012”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë antarësimin e Bashkisë së Tiranës, si anëtar i asociuar në Eurocities, rrjeti i qyteteve më të mëdha europiane.
2. Të kryhen të gjitha detyrimet nga Bashkia e Tiranës, sipas rregullave përkatëse për t’u bërë pjesë e Eurocities.
3. Të përmbushë detyrimin e pagesës vjetore të kuotës si anëtare e asociuar, në shumën 4000 (katër mijë) Euro në vit për vitin 2012 e në vijim.
4. Shpenzimet për efekt të pikës 3 të këtij vendimi, për pagesën e kuotës së anëtarit të asociuar për vitin 2012, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, për zbatim e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**